



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 197, Datë 03.09.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KODIT TE RRJETIT MBI  
RREGULLAT E NDËRVEPRIMIT DHE SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE**

Në mbështetje të neneve 16 ; 44; 55 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror“ dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s të ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe parashikimeve të Vendimit nr. 2018/02/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 03.09.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kodit i Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave.

**Konstatoi se:**

- Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “Albgaz”sha, ka adaptuar/përshtatur Kodin -e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, duke e paraqitur për shqyrtim dhe miratim në ERE me shkresën nr. 101 prot, datë 08.08.2018
- Ky Kod do të shqyrtohet dhe miratohet si detyrim i sa më poshtë:
- Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë (ESC) që nga data 01.07.2006;
- Parashikimeve të Rregullores të Bashkimit European (BE) nr. 715/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
- Kërkesave të Rregullores së Komunitetit të Energjisë (KE) 2015/703, të datës 30 prill 2015;
- Vendimit nr. 2018/02/PHLG.EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë me të cilin është miratuar *vetëm Kodi i Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave*, ndërsa dy të tjerët janë akoma në proces shqyrtimi për përshtatje dhe miratim nga vetë Komunitetit të Energjisë, procedura për shqyrtimin e tyre do fillojë pas miratimit nga ky i fundit.
- Parashikimeve të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”; Gjithashtu Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror “Albgaz”sha i lind e drejta për të aplikuar për shqyrtimin dhe miratimin e këtij Kodi duke qenë se:

- Shoqëria “Albgaz” sha, është e licencuar në aktivitetin e Transmetimit të dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror
- Është çertifikuar Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “Albgaz”sha, në përputhje me nenet 37, 59, 68, dhe 80 të Ligjit Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe nenit 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 të Komunitetit të Energjisë (EC).;
- “Albgaz”sha, gëzon statusin e vëzhguesit pranë ENTSO-G, Rrjetit European të Operatorëve të Transmetimit të Gazit Natyror.
- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ky Kod duhet të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave”.
2. Versioni në gjuhën e origjinës (Anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit Shqip.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**